

Shtojca 15

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. _____ Prot.

Data ____/____/ 2017

Për: **EVEREST SH.P.K** + G P G COMPANY Adresa: TIRANE, Kamez, Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur per Pune.

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **“Rikonstruksion i sheshit publik para hyrjes se portit, F II”**, me fond limit: **124’993’000** lekë, sasia sipas preventivit, afati **90 dite**.

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*):Buletini i Njoftimeve Publike.[**Nr.22, date 05 Qershor 2017**]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BE – IS SHPK

+ CURRI

Vlera **105’635’180**(Njeqind e pese milion e gjashteqind e tridhjet e pese mije e njeqind e tetedhjete)leke

2. EVEREST

+ G P G COMPANY

Vlera **118’697’400**(Njeqind e tetembedhjete milion e gjashteqind e nentehjete e shtate mije e katerqind)leke

3. ALKO-IMPEX General Construcion

Vlera **119’633’000**(Njeqind e nentembedhjete milion e gjashteqind e tridhjete e tre mije)leke

K71412003A

J67902718S

J78311921L

J64324443V

K91326028I

Te s’kualifikuar:

1. BE – IS SHPK + CURRI

2. ALKO-IMPEX General Construcion

Per arsyet e meposhtme:

- Ofertuesi **BE – IS SHPK + CURRI** me vlere te ofertes **105’635’180** lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

1- Ne kontraten e bashkepunimit te operatoreve ekonomoke, ka nje ndarje te punimeve ne masen **50%** per operatorin **BE – IS SHPK** dhe **50%** per operatorin **CURRI**.

Ne preventivin e paraqitur nga bashkimi i te dy operatoreve rezulton se operatori ne bashkim **BE – IS SHPK** ka mare persiper te kryej **i vetem** punimet e pikes **C02.01** te preventivit e konkretisht: **“Impianti per funksionimin e lojrave te ujit ne dysheme qe do te realizohet ne kendet e perimetrin te sheshit”**, punime keto qe kryhen nga subjekte me license profesionale te ndertimit te cilet disponojne

piken **NS.16-B** te licenses, operatori **BE – IS SHPK** nuk e disponon piken **NS.16-B** te licences.

2- Ne Dokumentat e Tenderit eshte kerkuar si me poshte vijon:

- **Certifikate ISO 9001 e prodhuesit per cilesine e produkteve te kerkuara me poshte:**

- *Ndricules shirit LED 1000mm, 3500k, 280lm, 8,5w, eficensa 32,9 lm/w,50,000 ore pune e inkastruar ne profil alumini 6x7x22mm, IP68. do te perdoret 65 ml per rotonden,73ml per shkallaren, dhe 50ml per ndricimin e sheshit.dhe 21 (1x1ml) per ndricimin e tavanit.*
- *Ndricules shirit LED 7000mm, 3500k, 2030lm, 59,5w, eficensa 134 lm/w,50,000 ore pune e inkastruar ne profil alumini i mbuluar me xham 6x7x22mm, IP68 do te perdoret per ndricimin e nenkalimit ne dysHEME dhe tavane si anesore dhe ne qender te rruge*
- *Ndricules ne forme spoti i inkastruar ne toke per palmat me dimen 140x177ne ngjyre inoksi220/240v, 50/60hz LED 4,5w, 113lm, Eficensa 25lm/w,50,000 ore pune, IP67 cdo peme do te kete dy ndricues.*
- *Ndricules ne forme spoti i inkastruar ne toke per Sheshin me dimen 150x150 mm ne ngjyre inoksi220/240v, 50/60hz LED7 w, 560-630 lm, Eficensa 100-110lm/w,50,000 ore pune, IP67 19 cope per sheshin dhe 3x4 kembet*
- *Ndricules LED 60w me dim 617x333x175 ne trup alumini, fluksi total i ndricuesit LED 6094lm, eficensa 100lm/w, 100,000ore pune, 3000K, IP67, te vendosura ne shtylla 10ml celiku te galvanizuara dhe te lyera me boj puder termostatike ne te ngrohte ne ngjyre gri antike me spesor 4mm.*

Per produktet e mesiperme operatori ekonomik duhet te vertetoje me marreveshje bashkepunimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, e-mail, website, etj., kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi, si dhe duhet te paraqiten **dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.)** te jene te perkthyer ne ato pjese qe pasqyrojne specififikimet teknike qe kerkohen ne dokumentat e tenderit, sipas te dhenave te treguara **ne preventive dhe specififikimet teknike** te dhena nga projektuesi dhe qe ofrohen nga ana juaj. **Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu**, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

- Operatori ne bashkim **BE – IS SHPK** ka paraqitur nje kontrate furnizimi te dates **10.12.2015** me afat **2(dy)** vjecar me shoqerine **ELAL COM SHPK** ku ky i fundit mer persiper te furnizoje shoqerine **BE – IS SHPK** me **“Materiale Elektrike”** sipas specifikimeve te kerkuara nga porositesi, **por kjo kontrate eshte e pergjitheshme dhe nuk eshte hartuar sipas kerkeses te autoritetit kontraktor ku kerkohet kontrate per te garantuar produktet konkrete te lartkerkuara**, gjithashtu, sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **ELAL COM SHPK**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Kontraktori i tregetise dhe sherbimeve, prodhim dhe tregetim te, ndricimit rrugor industrial dhe civil, zbarra metalike industriale dhe civile, kuadro elektrike me tension te ulet dhe te mesem, binaret, piktura elektrolitike e te gjitha produkteve per ndertesa shtyllat dhe panele. Prodhim dyersh te blinduara, impiante kondicionimi, aspirimi dhe sistemit hidraulik”;

por ne asnje rast shoqeria **ELAL COM SHPK nuk verteton** se do te garantoje funizimin me produktet e lartkerkuara qe kerkon Autoriteti Kontraktor(sipas Dokumentave te Tenderit) pasi **nuk** ka paraqitur **dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.)**, te cilat do te vertetonin se kjo shoqeri i prodhon produktet e lartkerkuara dhe do te garantonte furnizimin me keto produkte.

- Furnizuesi **ELAL COM SHPK** ka paraqitur nje dokument Bashkepunimi Tregetar me shoqerine **LTD** ku ky i fundit deklaroi se shoqeria **ELAL COM SHPK** eshte distributor i autorizuar i produkteve, **ndricues dhe aksesor total**. Sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **LTD**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Dizenjim, prodhim dhe trgtimin e poleve te ndricimit dhe paisje komplet- Prodhim dhe marketingun e materialeve te vendosjes ne toke dhe mbeshtetes per antena”;

por ne asnje rast shoqeria **LTD nuk verteton** se do te garantoje funizimin me produktet lartkerkuara qe kerkon Autoriteti Kontraktor(sipas Dokumentave te Tenderit), pasi ne kataloget e kesaj shoqerie te cilat jane ne gjuhe te huaj, por sipas fotove, shihen vetem **tela elektrike, morseta**

per lidhje elektrike, bulona, kapse dhe fasheta te ndryshme metalike qe i perkasin fushes elektrike dhe ne asnje rast nuk shohim produktet e lartkerkuar te cilat do te vertetonin se kjo shoqeri i prodhon produktet e lartkerkuara dhe do te garantonte furnizimin me keto produkte.

- Furnizuesi ELAL COM SHPK ka paraqitur nje dokument Bashkepunimi Tregetar me shoqerine **NORDEX** te dates **01/04/15** ku ky i fundit deklaroi se shoqeria ELAL COM SHPK eshte shperndares i produkteve tona te ndricimit te tilla si **projektuesit, reflektor industrial, ndricim rrugor dhe llambat**. Sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **NORDEX**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Tregetim dhe shitje te te gjith komponenteve te ndricimit dhe aksesoret”;

Shoqeria **NORDEX** duke qene se eshte shoqeri tregetuese dhe jo prodhuese, ne asnje rast **nuk** na verteton lidhjen e kesaj shoqerie me prodhuesit te cilet do te garantonin furnizimin me produktet e lartkerkuara sipas specifikimeve teknike qe kerkohen ne dokumentat e tenderit.

- Furnizuesi ELAL COM SHPK ka paraqitur nje dokument furnizimi me shoqerine **EATON** te dates **26/09/2016** ku ky i fundit deklaroi se shoqeria ELAL COM SHPK eshte shperndares i produkteve tona te **automatizimit, kontrollit dhe sinjalistikes**. Sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **EATON**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Distribucioni dhe riparimi e pajisjeve elektrike dhe elektronik, automatizimi e sistemeve dhe pajisjeve, shperndarjes se energjise si dhe te sistemeve te energjise elektrike”;

Shoqeria **EATON** duke qene se **nuk** eshte shoqeri prodhuese, ne asnje rast nuk na verteton lidhjen e kesaj shoqerie me prodhuesit te cilet do te garantonin furnizimin me produktet lartkerkuara sipas specifikimeve teknike qe kerkohen ne dokumentat e tenderit.

- Furnizuesi ELAL COM SHPK ka paraqitur nje dokument furnizimi me shoqerine **ZAMET** te dates **20/04/2017** ku ky i fundit deklaroi se shoqeria ELAL COM SHPK eshte shperndares i produkteve tona te tilla si **kanalina metalike dhe pajisje perkatese**. Sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **ZAMET**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Dizenjim, prodhim te kablove te shkarkimit, kanalineve metalike dhe kavove elektrike”;

por ne asnje rast shoqeria **ZAMET** **nuk verteton** se do te garantoje furnizimin me produktet lartkerkuara qe kerkon Autoriteti Kontraktor (sipas Dokumentave te Tenderit), pasi ne katalogun e kesaj shoqerie, qe eshte ne gjuhe te huaj, por sipas fotove, shihen **kanalina metalike** qe i perkasin fushes elektrike dhe ne asnje rast nuk shohim produktet e lartkerkuar te cilat do te vertetonin se kjo shoqeri i prodhon produktet e lartkerkuara dhe do te garantonte furnizimin me keto produkte.

- Furnizuesi ELAL COM SHPK ka paraqitur nje deklarate furnizimi me shoqerine **IRCE spa** ku ky i fundit deklaroi se shoqeria ELAL COM SHPK eshte distributor i autorizuar i produkteve tona, si **percjellesa te izoluar per trasmetimin e energjise**. Sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **IRCE spa**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Prodhimi i shufrave tel-bakrit “oksigen te lire”, telat elektrike dhe telave te bakrit dhe aluminit/kablo elektrike BT - MT/kabllo trampozuar”;

por ne asnje rast shoqeria **IRCE spa** **nuk verteton** se do te garantoje furnizimin me produktet lartkerkuara qe kerkon Autoriteti Kontraktor (sipas Dokumentave te Tenderit), pasi ne katalogun e kesaj shoqerie, qe eshte ne gjuhe te huaj, por sipas fotove, shihen **shufra tel bakri** qe i perkasin fushes elektrike dhe ne asnje rast nuk shohim produktet e lartkerkuar te cilat do te vertetonin se kjo shoqeri i prodhon produktet e lartkerkuara dhe do te garantonte furnizimin me keto produkte.

- Furnizuesi ELAL COM SHPK ka paraqitur nje deklarate furnizimi me shoqerine **URMET** te dates **27/01/2017** ku ky i fundit deklaroi se shoqeria ELAL COM SHPK eshte distributor i autorizuar i produkteve tona: **sistemi i citofonise, sistemi antizjarr sensore te tjere**. Sipas Certifikates **ISO 9001** te shoqerise **URMET**, kjo shoqeri operon ne fushat e meposhtme operative:

“Projektimi, zhvillimi, industrializimi, prodhimi, shitja, marketingu, asistenca teknike, mirembajtjen, instalimin dhe aktivizimin e sistemeve dhe sistemeve te integruara te citofonise, video-citofonia, siguri, telefoni. Publikim /privat, video surviim, impiante fotovoltaike, (nepermjet kabllit dhe radio), temperatura e kontrollit, pajisjet elektronike per rregullimin, matjen dhe kontrollin, sistemet elektronike, per ndertimin e automatizimit, mekanizmat dhe aksesoret per automatin rezidencial dhe industriale, pajisjet elektronike te telegjences, dhe telesoccorso, sistemet e sistemet e sherbimeve per nje vlere te shtuar (VAS) per rrjetin e telekomunikimeve publike, private stacionet e dijeve per intercellzione ligjore, qendrat e thirrjeve, IVR, sistemet e regjistrimit.

*Rregjistrimi i kartave telefonike. Shebimi i riparimit dhe rigjenerimit te sistemeve te telekomunikacionit. **Fissi, Tregtimi i produkteve per ndricim LED**”*

por ne asnje rast shoqeria **URMET nuk verteton** se do te garantoje funizimin me produktet lartkerkuara qe kerkon Autoriteti Kontraktor (sipas Dokumentave te Tenderit), pasi ne katalogun e kesaj shoqerie, qe eshte ne gjuhe te huaj, por sipas fotove, shihen **aparate te ndryshme telefonike citofone** dhe ne asnje rast nuk shohim produktet e lartkerkuar te cilat do te vertetonin se kjo shoqeri i prodhon produktet e lartkerkuara dhe do te garantonte furnizimin me keto produkte. Persa i perket fushveprimit **“Tregtimi i produkteve per ndricim LED”** qe eshte deklaruar ne Certifikaten **ISO 9001** te shoqerise **URMET** kjo shoqeri **nuk** na verteton lidhjen e kesaj shoqerie me prodhuesit te cilet do te garantonin funizimin me produktet lartkerkuara sipas specifikimeve teknike qe kerkohen ne dokumentat e tenderit.

- Ndersa ofertuesi ne bashkim **CURRI** per produktet e lartkerkuara **nuk** ka paraqitur dokumentacion.

3- Gjithashtu per produktet e kerkuara ne dokumentat e tenderit si me poshte:

- *Impianti per funksionimin e lojerave te ujit ne dysheme qe do te realizohet ne kendet e perimetrit te sheshit;*
- *Pompe zhytесе. me fuqi W=20KW;*

Operatorët ne bashkim **BE – IS SHPK + CURRI** per keto produkte **nuk** kane paraqitur dokumentacion.

4- Kerkohet:

- *Çertifikat: Sistemi i manaxhimit te sigurise se trafikut rrugor ISO 39001*

operatori ne bashkim **BE – IS SHPK** ka paraqitur certifikate ISO 39001, KVO konstatoi se vlefshmeria e kesaj certifikatave eshte deri me date **23/06/2017** por e vlereson si proces ne vazhdimesi.

- Per sa u vleresua me sipër: **Komisioni i Vleresimit te Ofertave** vendosi qe ofertuesi **BE – IS SHPK + CURRI** te mos kualifikohet.

- Ofertuesi **ALKO-IMPEX General Construcion** me vlere te ofertes **119’633’000** lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

1- Ne **3(tre)** zera punimesh te preventivit te tij **nuk** ka dhene oferte, vlerat ne **Cmim** dhe **Shume** jane **zero**.

2- Ne Dokumentat e Tenderit eshte kerkuar si me poshte vijon:

- **Certifikate ISO 9001 e prodhuesit per cilesine e produkteve te kerkuara me poshte:**

- *Impianti per funksionimin e lojerave te ujit ne dysheme qe do te realizohet ne kendet e perimetrit te sheshit;*
- *Pompe zhytесе. me fuqi W=20KW;*

ofertuesi **ALKO-IMPEX General Construcion** per keto produkte **nuk** ka paraqitur dokumentacion.

- Per sa u vleresua me sipër: **Komisioni i Vleresimit te Ofertave** vendosi qe ofertuesi **ALKO-IMPEX General Construcion** te mos kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se: **EVEREST SH.P.K** + G P G COMPANY Adresa: TIRANE, Kamez, Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit, me një vlerë të përgjithshme prej **118'697'400**(Njeqind e tetembedhete milion e gjashteqind e nentehjete e shtate mije e katerqind)leke është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Durres ne Njesine e Prokurimit, tel/fax 052 800 941, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtedhete) diteve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.07.2017

Ankesa: ka ose jo __ **Jo** __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



Titullari i Autoritetit Kontraktor
Vangjush DAKO